



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1234/x Prot.

Durrës më, 15.05.2026

VENDIM

Nr. 69, datë 15.05.2026

PËR

**"DISA SAKTESIME NE VENDIMIN NR. 61, DATË 23.04.2026 "PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.
159, DATË 21.11.2025 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN
E REVISTËS SHKENCORE UNIVERSITARE "INTERDISCIPLINARY JOURNAL
OF RESEARCH AND DEVELOPMENT" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 159, datë 21.11.2025 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Revistës Shkencore Universitare 'Interdisciplinary Journal Of Research and Development' në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"; në Vendimin nr. 61, datë 23.04.2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik nr. 159, datë 21.11.2025 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e revistës shkencore universitare "Interdisciplinary Journal of Research and Development" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"; si dhe në saktësimet e përcjella nga Grupi i Punës në vijim të kërkesës së Bordit të Administrimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 15.05.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e saktësimeve në Rregulloren për Funksionimin e Revistës Shkencore Universitare "Interdisciplinary Journal Of Research And Development" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, të ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i kalon për miratimin e termave financiarë Bordit të Administrimit.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

RREGULLORE

PËR FUNKSIONIMIN E REVISTËS SHKENCORE UNIVERSITARE

"INTERDISCIPLINARY JOURNAL OF RESEARCH AND
DEVELOPMENT"

NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

*Miratuar me Vendimin Nr.159, datë 21.11.2025 të Senatit Akademik të Universitetit
"Aleksandër Moisiu" Durrës, e ndryshuar me Vendim nr. 69, datë 15.05.2026 të
Senatit Akademik*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim ofrimin e kornizës ligjore dhe operative për organizimin, funksionimin, financimin, strukturën editoriale, procedurat e botimit dhe standardet etike të Revistës Shkencore Universitare "Interdisciplinary Journal of Research and Development" (IJRD) në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD). Ajo synon të sigurojë respektimin e standardeve të larta akademike dhe etike, në përputhje me rregulloret e UAMD-së.

Rregullorja harmonizohet me standardet ndërkombëtare të publikimeve shkencore, duke ndjekur parimet e Komitetit të Etikës së Botimit (COPE), për të garantuar transparencë, integritet shkencor dhe akses të hapur.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore, mbështetet në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 35/2016, "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të", për mbrojtjen e pronësisë intelektuale; Ligjin nr.124/2024, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në përputhje me Rregulloren Europiane GDPR (Reg. (EU) 2016/679); Parimet e COPE (Komiteti i Etikës së Botimit); Licencën e Creative Commons (CC BY 4.0) për shpërndarjen e materialeve shkencore; Planin e Zhvillimit Strategjik 2025-2030 UAMD, miratuar me vendimin nr.58 dt. 18.12.2024 nga Senati Akademik; Kodin e Etikës në Kërkimin Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Neni 3

Objektivat e rregullores

1. Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit, funksionimit, administrimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit për botim të artikujve shkencorë në revistën "IJRD" të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kjo rregullore synon garantimin e cilësisë shkencore dhe etike, sigurimin e pavarësisë editoriale, ndërkombëtarizimin e saj, si dhe vendosjen e procedurave transparente për publikim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

KREU II

REVISTA SHKENCORE DHE ORGANET DREJTUESE

Neni 4

Statusi i revistës

1. Revista "Interdisciplinary Journal of Research and Development" (IJRD) është revistë shkencore ndërdisiplinore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës që funksionon si revistë me akses të hapur.
2. Revista është e pajisur dhe identifikohet me ISSN të vlefshëm: ISSN 2410-3411 dhe E-ISSN 2313-058X.
3. Revista është publikuar për herë të parë në vitin 2014, me periodicitet dy numra standard në vit, dhe prej vitit 2022 vijon me periodicitet tre numra standard (Issue) në vit, Mars, Korrik, Nëntor. Numri i punimeve të publikuara në një numër standart (Issue) të revistës do të jetë maksimumi deri në 50 artikuj.
4. Revista është e anëtarësuar në platformën digjitale *Publishers International Linking Association Crossref* dhe është e pajisur me DOI (*Digital Object Identifier*), ku çdo artikull i publikuar identifikohet me një DOI të veçantë dhe me anë të tij bëhet ndërlidhja e referencave me artikullin e publikuar.
5. IJRD është e indeksuar në bazat e të dhënave dhe platforma të ndryshme ndërkombëtare.

Neni 5

Objektivat e revistës

1. Promovimi i kërkimeve të reja shkencore, studimeve të rasteve dhe zhvillimeve intelektuale origjinale në fusha ndërdisiplinore.
2. Botimi i revistës në përputhje me standardet ndërkombëtare të publikimeve akademike.
3. Të kontribuojë në rritjen e impaktit akademik të UAMD-së, përmes indeksimit në platforma ndërkombëtare të njohura si Scopus, Web of Science etj.
4. Të sigurojë një platformë me akses të hapur online, për shkëmbimin global të punimeve shkencore mes akademikëve, studiuesve, ekspertëve të fushës dhe kërkuesve të rinj.
5. Të rrisë vizibilitetin ndërkombëtar të UAMD-së dhe të nxisë bashkëpunimin akademik global.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

Neni 6

Organet drejtuese të revistës

1. Revista ka këtë strukturë organizative:
 - a. Kryeredaktori (Editor-in-Chief)
 - b. Bordi Ekzekutiv Drejtues (Executive Steering Committee)
 - c. Bordi Editorial (Editorial Board)
 - d. Sekretaria e Revistës
2. Sekretaria e revistës dhe koordinimi administrativ i artikujve me autorët dhe recensentët (reviewers) menaxhohen nga Qendra për Kërkim dhe Ekselencë.
3. Çdo organ ushtron kompetencat e veta në përputhje me këtë rregullore dhe standardet akademike të botimit.

Neni 7

Kryeredaktori

1. Revista drejtohet nga Kryeredaktori, i cili emërohet nga Rektori me miratimin e Bordit Editorial.
2. Ai siguron cilësinë shkencore të punimeve dhe mbikëqyr procesin e recensës (review).
3. Në koordinim me Bordin Ekzekutiv Drejtues, jep miratimin final për publikimin apo refuzimin e artikujve të revistës.

Neni 8

Bordi Ekzekutiv Drejtues

Ushtron funksion kontrolli, verifikimi dhe mbikëqyrjeje mbi procesin editorial dhe, në mënyrë të veçantë:

1. Shqyrton artikujt që kanë kaluar procesin e recensës (review);
2. Verifikon nëse janë zbatuar rekomandimet e recensentëve (reviewers);
3. Kontrollon përputhshmërinë e artikullit me standardet shkencore, etike, teknike dhe redaksionale të revistës;
4. Bashkëpunon me Kryeredaktorin për kontrollin përfundimtar të artikujve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

5. Jep miratimin përfundimtar institucional-editorial për botim së bashku me Kryeredaktorin

Neni 9

Bordi editorial

1. Bordi editorial përbëhet nga akademikë dhe profesorë të shquar brenda dhe jashtë vendit.
2. Anëtarët e Bordit editorial ftohen nga Kryeredaktori dhe Rektori bazuar në ekspertizën akademike dhe kontributin e tyre në fusha ndërdisiplinore.
3. Kryeredaktori dhe Rektori mund të shqyrtojnë edhe vetëkandidimet e profesorëve vendas dhe të huaj për anëtarësim në Bordin Editorial. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me mundësi rinovimi.
4. Bordi Editorial ka funksion këshillimor dhe shkencor dhe kontribuon në:
 - a. garantimin e profilit akademik dhe cilësisë shkencore të revistës;
 - b. sugjerimin e recensentëve (reviewers) dhe ekspertëve të fushës;
 - c. promovimin kombëtar dhe ndërkombëtar të revistës;
 - d. dhënien e mendimeve profesionale për zhvillimin dhe standardet e revistës.

Neni 10

Sekretariati administrativ

1. Sekretaria e Revistës ndjek procedurat administrative dhe teknike të artikujve, komunikimin me autorët dhe recensentët (reviewers), si dhe dokumentimin e të gjitha fazave të procesit editorial.
2. Sekretaria ka për detyrë përgatitjen teknike, formatimin, arkivimin digjital të artikujve dhe botimin e numrave të revistës.
3. Sekretaria drejtohet dhe monitorohet nga Drejtori i Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë.

Neni 11

Emërimi, mandati dhe trajtimi financiar i Bordit Ekzekutiv Drejtues

1. Bordi Ekzekutiv Drejtues drejtohet nga Rektori i Universitetit "Aleksandër Moisiu".
2. Bordi përbehet nga Rektori dhe 5 anëtarë të cilët emërohen nga Rektori në bashkëpunimin me Kryeredaktorin me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
3. Përbërja e Bordit Ekzekutiv Drejtues përcaktohet me akt të posaçëm të Rektorit, sipas nevojave të funksionimit të revistës dhe profilit të saj akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

4. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv Drejtues përfitojnë pagesë vjetore për ushtrimin e detyrave të tyre në kuadër të funksionimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së procesit editorial të revistës. Masa e pagesës për secilin anëtar është 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë të reja në muaj.
5. Pagesa e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni kryhet sipas akteve financiare dhe administrative në fuqi të Universitetit.

KREU III

PROCESI I PRANIMIT, VLERËSIMIT DHE BOTIMIT

Neni 12

Paraqitja e artikujve

1. Revista publikohet vetëm në gjuhën angleze. Artikujt për botim dorëzohen nga autorët në adresën zyrtare elektronike të revistës: ijrd@uamd.edu.al.
2. Artikujt duhet të jenë origjinalë, të pabotuar më parë dhe të mos jenë në shqyrtim paralel në revista të tjera.
3. Autorët janë përgjegjës për përmbajtjen shkencore, saktësinë e të dhënave, korrektësinë e citimeve dhe respektimin e normave etike të botimit.

Neni 13

Profili ndërkombëtar i autorëve

1. Revista synon të sigurojë një përfaqësim të balancuar sipas standarteve të Scopus dhe Elsevier, në përputhje me karakterin e saj akademik dhe ndërkombëtar.
2. Për çdo vit akademik, si dhe në përbërjen e numrave të saj, revista duhet të synojë të ruajë raportin sipas standarteve të Scopus dhe Elsevier.
3. Për një përfaqësim sa më ndërkombëtar të revistës, do të vlerësohet pozitivisht pjesëmarrja e autorëve nga vende, universitete dhe rajone të ndryshme, me synim shmangien e përqendrimit të botimeve vetëm në një hapësirë të kufizuar kombëtare ose institucionale.
4. Në rastet e bashkëautorësisë, artikulli do të konsiderohet me përfaqësim ndërkombëtar kur të paktën një nga autorët të jetë i afiluar në një institucion të huaj.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT**

Neni 14

Kontrolli paraprak i artikujve

1. Me dërgimin e artikujve në adresën e revistës, sekretaria i konfirmon çdo autori, përmes e mailit, marrjen e punimit dhe më pas e kalon atë për shqyrtim në fazën paraprake mbi përputhshmërinë e elementëve standard të kërkuar.
2. Në vijim artikulli kontrollohet për:
 - a. plagjaturë,
 - b. përdorimi i papërshtatshëm i inteligjencës artificiale (AI), detaje mbi përdorimin e AI-së janë të publikuara në faqen zyrtare të revistës.
 - c. respektimin e standardeve etike dhe akademike.
3. Në fund të procesit paraprak të shqyrtimit, artikujt që nuk përmbushin kriteret minimale të revistës të botuara në webin zyrtar të revistës, mund të refuzohen pa kaluar në fazën e recensës (review).

Neni 15

Procesi i vlerësimit shkencor

1. Artikujt që kalojnë procesin paraprak të shqyrtimit u dërgohen për vlerësim profesionistëve të fushës, nëpërmjet një procesi "double-blind", i cili përbëhet nga minimumi dy recensentë (reviewers) të pavarur.
2. Kohëzgjatja e procesit të recensës zgjat nga 4 deri në 8 javë që nga dorëzimi i punimit.
3. Vlerësimi kryhet mbi bazën e cilësisë shkencore, originalitetit, metodologjisë, relevancës dhe kontributit akademik të artikullit.
4. Recensentët (reviewers) mund të rekomandojnë:
 - a. pranimin e artikullit,
 - b. pranimin me pak korrigjime,
 - c. pranimin me shumë korrigjime,
 - d. refuzimin e artikullit.

Neni 16

Miratimi përfundimtar dhe botimi

1. Artikujt e pranuar nga recensentët (reviewers) i nënshtrohen shqyrtimit përfundimtar nga Bordi Ekzekutiv Drejtues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

2. Bordi Ekzekutiv Drejtues verifikon përputhshmërinë e artikullit me standardet shkencore, editoriale dhe etike të revistës.
3. Miratimi përfundimtar për botim jepet vetëm pas vendimit pozitiv të këtij Bordi në bashkëpunim me Kryeredaktorin e revistës.

KREU IV

AUTORËSIA, E DREJTA E PRONËSISË DHE ETIKA E BOTIMIT

Neni 17

Politika e etikës së botimit

1. Revista IJRD zbaton parimet e Komitetit të Etikës së Botimit (COPE), duke respektuar standardet ndërkombëtare për transparencë, integritet dhe praktikat më të mira në botimet shkencore.
2. Recensentët (reviewers) janë të detyruar të garantojnë paanshmërinë në procesin e vlerësimit, konfidencialitetin e materialeve të dorëzuara dhe menaxhimin e çdo konflikti interesi që mund të lindë gjatë procesit editorial.
3. Autorët duhet të sigurojnë që punimet e tyre janë origjinale, të pashpërndara më parë dhe pa përmbajtje plagjiature, si dhe, të deklarojnë qartë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në interpretimin ose paraqitjen e rezultateve kërkimore.
4. Recensentët (reviewers) mbajnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të materialeve që u dërgohen për shqyrtim, duke siguruar vlerësim objektiv dhe profesional.
5. Çdo shkelje e parimeve etike trajtohet nga redaksia në përputhje me politikat e COPE dhe mund të sjellë masa si:
 - tërheqje zyrtare e artikullit,
 - njoftim formal publik,
 - refuzim i botimit të ardhshëm për një periudhë të caktuar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT**

Neni 18

Autorësia dhe e drejta e pronësisë

1. Pas pranimit të punimit për botim, autorët, automatikisht transferojnë të drejtën e botimit tek revista IJRD, duke ruajtur të drejtat morale mbi veprën e tyre dhe duke e shpërndarë nën licencën Creative Commons Attribution-NonCommercial 4.0 International License (CC BY-NC 4.0).
2. Autorët kanë të drejtë të shpërndajnë versionin final të botuar në faqet e tyre personale, në arkiva institucionale apo rrjete kërkimore (p.sh. ResearchGate, Academia.edu), duke cituar burimin original të botimit dhe DOI-n përkatës.

Neni 19

Politika e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave

1. Revista IJRD respekton Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), duke mbledhur dhe përpunuar vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për procesin editorial (emër, mbiemër, tituj akademikë/shkencorë, institucion, shtet dhe adresë kontakti).
2. Të dhënat personale të autorëve, recensentëve (reviewers) dhe redaktorëve përdoren ekskluzivisht për qëllime komunikimi dhe administrimi editorial dhe nuk shpërndahen tek palë të treta, përveç rasteve të kërkuara nga ligji ose autoritetet përkatëse.
3. Revista garanton ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave në mënyrë të sigurtë dhe për një periudhë të kufizuar kohore, në përputhje me politikat institucionale të mbrojtjes së të dhënave.

Neni 20

Tarifa e botimit

1. Revista aplikon një tarifë publikimi prej 30.000 (tridhjetë mijë) lekë ose 300 (treqind) euro për çdo artikull të pranuar për botim. Kjo tarifë fillon me datë 01/01/2027 dhe mund të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
INTERNATIONAL JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

rishikohet, si dhe çdo ndryshim i saj publikohet në faqen zyrtare të revistës, pasi të ketë marrë miratimin për ndryshimet përkatëse nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

2. Tarifa e publikimit paguhet vetëm pasi artikulli ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit përfundimtar.
3. Kur autori i parë është nga stafi akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu", me autorësi të vetme ose me bashkëautorësi me autorë nga IAL-të apo institucione të tjera vendase dhe të huaja, punimi do të përjashtohet nga tarifa (fee) e publikimit.
4. Punimet me disa autorë, me autorë të parë nga IAL-të apo institucione të tjera vendase dhe të huaja, që kanë si bashkëautorë anëtarë nga stafi akademik i UAMD-së, do të kenë një pagesë të reduktuar në masën 50 % të tarifës së publikimit.
5. Punimet e paraqitura nga Anëtarët e Bordit Editorial ose Recensentët, në të cilat janë autor i parë, me autorësi të vetme ose në bashkëautorësi, përjashtohen nga tarifa e publikimit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

1. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë rregullore zgjidhen nga Editor-in-Chief, në bashkëpunim me Bordin Ekzekutiv Drejtues në përputhje me të gjitha aktet dhe statutet e UAMD si dhe me politikat e revistës (psh: review policy, copyright, publication ethics etj) të publikuara në faqen web zyrtare të cilat janë miratuar nga Kryeredaktori dhe Bordi Ekzekutiv Drejtues.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga organet kompetente të universitetit dhe zbatohet për të gjitha proceset e botimit të revistës IJRD.